



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.74/2016

Prishtinë, më 18.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Rrustem Berisha, Enver Hoti, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Duda Balje, anëtarë si dhe Faton Topalli, deputet.

Munguan: Glauk Konjufca dhe Sasha Milosavljeviq, zv.kryetar.

I ftuar: Lutfi Zharku Ministër i Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Fiza Hoxha, Mustafë Krasniqi dhe Adem Krasniqi – Ministria e Infrastrukturës; Dardan Abazi – INDEP; Etleva Malushaj – LVV; Fjolla Uka – KDI; Shefki Kastrati – NDI; Rrahman Ramaj – BIRN; Arlinda Bajrami – Instituti GAP; Kenan Gashi – Rrjeti i OJQ-ve AVONET.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 4, 6, 7 (I) dhe 7 (II).10.2015;
3. Raportim i z.Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, për zhvillimet në fushë veprimtarin e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm;
4. Të ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datës 4, 6, 7 (I) dhe 7 (II).10.2015;

Raif Qela- Edhe pse me vonesë e kam marrë njërin nga procesverbalet e mbledhjes së datës 7.10.2016, prandaj, kërkoj që këtë procesverbal ta miratojmë në një mbledhje tjetër.

Fatmir Rexhepi- Mendoj që procesverbali nr.72, i datës 7.10.2016 është i mangët dhe kërkoj që të rishikohet nga stafi.

Muhamet Mustyafa, kryetar - Propozoj t'i shtyjme këto të dy procesverbale të datës 7.10.2016 për aprovim në mbledhjen tjetër për arsye se ka qenë mbledhje e vonë dhe mund të ketë shpëtuar diçka në proces, por incizimet ekzistojnë dhe lus kolegët që kanë sugjerime që ti paraqesin tek shërbimi dhe në mbledhjen tjetër do t'i miratojmë. Ne fund, kërkoj nga administrata që të transkribohet mbledhja për shkak të rëndësisë së saj.

Propozimet e anëtareve të Komisionit u përkrahën, ndërsa u miratuan vetëm procesverbalet e datës 4 dhe 6.10.2016.

3. Raportim i z. Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, për zhvillimet në fushe veprimtarinë e ministrisë, në realizimin e prioriteteve në aspektin buxhetor për këtë vit dhe vitin e ardhshëm

Lutfi Zharku, inistër i Ministrisë së Infrastrukturës, paraqiti para deputetëve objektivat e Ministrisë për Infrastrukturë, implementimin e projektit të Autoudhës R6 -Prishtinë– Hani i Elezit, bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare, projektet në hekurudha, legjislacionin primar dhe sekondar etj.

Ministrit i shtruan pyetje dhe ngritën çështje anëtarët e Komisionit, si **Fatmir Rexhepi, Rustem Berisha, Besim Beqaj, Blerim Grainca, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Enver Hoti, Duda Balje si dhe deputeti Faton Topalli,** të dhena në transkript pjesë e këtij procesverbali.

Komisioni pas debatit nxori këtë:

Përfundim

Komisioni dhe Ministria të vazhdojnë bashkëpunimin, në të mirë të zhvillimit të infrastrukturës rrugore, hekurudhore dhe trafikut në përgjithësi, si dhe inkurajohet Ministria që ta hartojë një strategji afatgjate për rrugët.

4. Të ndryshme.
Çështjet vijuese

Kryetari i njoftoi deputetët që ka hartuar shkresën, ku në emër të Komisionit do ti drejtohet Gjykatës Kushtetuese, lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Trepçën.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, të miratimi i rendit të ditës, a keni vërejtje, jo, ok. Të proceverbali, i kemi pas javen e kaluar katër mbledhje...pra ato të datës 4, 6, 7 ora 19:30 dhe 7.10.2015 ora 23:30...i keni marr proceset.

Raif Qela, edhe pse me vonesë e kam marrë njërin nga procesverbalet e mbledhjes së datës 07.10.2016...andaj, kërkoj që këtë procesverbal ta miratojmë në një mbledhje tjetër.

Fatmir Rexhepi, mendoj që procesverbali i mbledhjes që është me numër 72 i datës 07.10.2016 është i mangët dhe kërkoj që të rishikohet nga stafi sepse ka lëshime nuk është në rregull.

Kryetari, atëherë propozoj t'i shtyjme këto të dy procesverbale të datës 07.10.2016 për aprovim në mbledhjen tjetër për arsye se ka qenë mbledhje e vonë dhe mund të ketë shpëtuar diçka në proces. Ka qenë vonë... por incizimet ekzistojnë dhe lus kolegët që kanë sugjerime që ti paraqesin tek shërbimi dhe në mbledhjen tjetër do t'i miratojmë. Kërkoj nga administrata që të transkribohet mbledhja për shkak të rëndësisë së saj. Dhe i miratojmë vetëm këto dy tjerat. A pajtohem. Ok.

Unë do dal jashtë më një takim të shkurtë dhe derisa të kthehëm kryesimin e mbledhjes e bën deputeti Fatmir Rexhepi. Minister e ke fjalën.

Lutfi Zharku, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës, paraqiti para deputetve objektivat e ministrisë në infrastrukturë, implementimin e projektit të Autoudhës R6 - Prishtinë – Hani i Elezit, bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare për rrugën R7 (Besi – Merdare), zgjerimi i hyrje-daljeve në Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan, vazhdimin e zgjerimit të rrugëve Nacionale N2 (Prishtinë – Mitrovicë) dhe N9 (Gjurgjicë – Kijevë) dhe (Zahaq – Pejë), zgjerimi i rrugës regjionale R102 Komoran - Skenderaj segmenti: Klinë e Epërme – Morinë, programin e rehabilitimit të rrugëve Nacionale dhe Regjionale, programin e bashkëfinancimit me Komuna për përmirësimin e gjendjes së rrugëve lokale. Ai tha se vazhdojnë punët në infrastrukturën rrugore bashkefinancim me komuna në shifra investime në vlerë prej 189 milion euro, shumica në autostradë (148 milion euro) 261 km rrugë, 54 për projekte kapitale, në autostradën R 6 Prishtinë – Hani i Elezit, është duke vazhduar me punime pothuajse në tërë trasenë. Janë hapur 50 Km të trasës së autostradës dhe 20 km të asfaltura, kanë përfunduar 8 Mbikalime dhe 5 nënkalime të cilat janë lëshuar në qarkullim, ka përfunduar procesi i shpronësimit për segmentet C1 dhe C2 , deri në Doganaj, është përgatitur Drafti Final i Projektit për segmentin C3 Kyqja Doganaj – Hani i Elezit, presim që në nëntor të lëshojmë në qarkullim segmentin F.Kosovë – Babush. Ministria e Infrastrukturës në bashkëpunim me EIB-in dhe EIB-ne, ka filluar plotësimin e studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor si dhe të projektit preliminar për segmentin Besi - Merdare (kufiri me Serbinë). Në bashkëpunim me EIB-in dhe BERZH-ka filluar plotësimi i studimit të fizibilitetit dhe ndikimit mjedisor për segmentin Kijevë – Zahaq (32 Km), si dhe plotësimi i projektit zbatues. Janë inicuar procedurat e prokurimit për realizimin e punimeve, ku janë përfshirë të gjitha kërkesat të cilat kanë qenë të arsyeshme, janë përfunduar punimet në segmentin Gjurgjicë – Mleqan), punohet në ndërtimi i urës dhe kontrata e punimeve shtesë për rrugë lidhëse dhe nënkalime, gjatë këtij viti presim të realizohet në tërësi.Paralel me këtë po mundohemi të gjejmë zgjidhje për hartimin e studimit të fizibilitetit për nënkalimin hekurudhor në Ferizaj. TRAINKOS SH.A, aktualisht operojnë dhjetë (10) linja të trenit në transportin e udhëtareve, kemi subvencione në vlerë prej 731,959.00 euro. Janë inicuar

nismat për lidhjen e marrëveshjeve bilaterale për transport me Malin e Zi, Maqedonine, Holand, Belgjikë, Luksemburg, Norvegji dhe Shqipërinë. Është nënshkruar ndryshimi dhe plotesimi i Marrëveshjes me Bullgarinë, në transportin rrugor të udhëtareve janë lëshuar: 112 leje bilaterale, dhe 127 leje në transportin e rregullt ndërkombëtar. Janë lëshuar 336 certifikata të autobusëve dhe 50 licenca të transportit të udhëtarëve (29 licenca D, 21 licenca C, 7 licenca B dhe 3 licencë A). Janë lëshuar licenca për transport të mallrave dhe mallrave të rrezikshme: 60 licenca për palë të tretë me qira dhe pagesë, 11 licenca për nevoja personale, 11 licenca për transport të mallrave të rrezikshme dhe 2 licenca për terminale kurse janë lëshuar edhe 100 certifikata ADR për shofer dhe 20 certifikata ADR për manipulues. Certifikata të kamionit të lëshuara për këtë periudhë janë 338 sosh të bazuara në licencën për palë të tretë me qira dhe pagesë dhe 52 certifikata të bazuara në licencë për nevoja personale. Ndërkohë janë lëshuar edhe 1942 leje për transport të mallrave: për Bullgari 975, për Turqi 322, për Itali 515, për Hungari 24, Kroaci 2, Shqipëri 2 (leje për vende të treta) si dhe për Austri 104 leje, Slloveni. Trafiku Ajror është zhvilluar në 27 destinacione, janë aprovuar 12 lejet e operimit për Avio Kompani ajrore të rregullta dhe sezonale, 168 leje të fluturimit Ad Hoc dhe janë autorizuar lejet e fluturimit për 3 kompani ajrore të BE-së. Trafiku ajror gjatë 9 muajve të këtij viti është në rritje në krahasim me vitin 2015 për 10.9% (rritje me të mëdha në Shkurti -21% dhe Marsi - 21.9 %). Numri i përgjithshëm i udhëtareve në këtë periudhë është 1,349,880. Komisioni Evropian ka bërë vlerësimin teknik të zbatimit të Marrëveshjes për Shfrytëzimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit Civil duke konstatuar se i kemi përmbushur të gjitha obligimet e dala nga HPEA. Ka vazhduar emetimi i Animacionit për të drejtat e pasagjerve disa herë në televizionin publik, me qëllim të sensibilizimit të drejtave të pasagjerve për mbrojtjen e tyre nga mashtrimet dhe aktivitetet e vazhdueshme preventive ka ndikuar që të arrihet mbrojtja e të drejtave të pasagjerve. Ministria e Infrastrukturës po vazhdon me inspektime të rregullta në: transportin rrugor, infrastrukturë rrugore, qendra të kontrollave teknike të automjeteve, dhe auto shkola. Gjithsej inspektime nga tereni janë 2757, prej tyre 404 me vendime dhe 419 incime me procedurë kundërvajtëse-gjyqësore. Sa i përket legjislacionit Kuvendi i Kosovës ka miratuar dy ligje, Ligji për Patent Shofer, dhe për Ligji për Rregullat e Trafikut, Projektligji i Automjeteve shkon këtë javë në Qeveri. Është plotësuar strategjia legjislative me: Ligji mbi rrugët, dhe Ligji për transportin rrugor. Janë nënshkruar 4 Udhëzime Administrative: për Procedurat dhe Tarifat e Inspektimit dhe Certifikimit të Automjeteve për Transport të Mallrave të Rrezikshme; për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 4/2012 Për Dhënien e Certifikatës së Sigurisë dhe Autorizimin e Sigurisë për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherët e Infrastrukturës Hekurudhore; për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2013 Mbi Stabilimentet dhe Pajisjet për Ngasje të Automjeteve Motorike me Gaz (në përputhje me vendimin 12/44 të Qeverisë), dhe për Kontrollimin Teknik të Automjeteve (në përputhje me vendimin 12/44 të Qeverisë). Po punohet edhe në 6 UA të cilat do të përfundojnë deri në fund të vitit. Është bërë inaugurimi i projektit “instalimi i kamerave monitoruese” në 7 qendrat e testimit të pjesës teorike të provimit për patentë shoferë si dhe monitorimi me “kamerë duale” në automjet, i pjesës praktike të provimit për patentë shoferë. Projekti “E-Shoferi” dhe është në implementim e sipër me të cilin krijohet baza e të dhënave për autoshkola, shofer instruktor, ligjërues profesional duke përfshirë edhe modulën e aplikimit on-line të kandidatëve për patentë shoferë. Projektin “E-Testimi” është në fazën e vlerësimit. Fluksi i madh i kandidatëve për shofer: Provimi teorik 77,692 kandidatë, Provimi praktik 42,767 kandidatë, Provimi i kanës kaluar gjithsej 29,377 kandidatë. Kontrollimin teknik e kanë kryer 228,033 automjete, mbetet bregu edhe me tutje mbikqyrja e kryerjes kualitative të këtij shërbimi, duke

marre parasysh se vetem 1.11% (2,541 automjete) nuk e kane kaluar testin e rregullsise. Me qëllim të ruajtjes së ambienti prej 1 korrikut ka filluar matja e gazrave të lira nga automjetet. Gjashtëmujori i parë i testimit të gazrave është i karakterit eksperimental dhe në bazë të rezultateve të treguara do të mirren hapat konkret. Sa i përket importit të automjeteve: automjetet e përdorura 93 % - ominojnë aotomjetet e përdorura deri në 10 vite, 9938 (53 % e veturave të importuara), automjete të reja 7 %.

Kryetari, ju falënderoj shumë z. Zharku për këtë prezantim mjaftë detal, tani do të hapim pjesën e debatit për pyetjet dhe komentet e juaja si dhe pjesën e përgjigjeve nga Ministri dhe stafi i tij. Ajo çka bie në sy nga raporti i juaj është pa dyshim një aktivitet i gjerë ku natyrisht se investimet në projektin e autostradës marrin energjinë më të madhe dhe fondet më të mëdha dhe ky projekt është filluar në qeverisjen e mëparshme dhe tani për arsye të obligimeve kontraktuese është dashtë të vazhdohet dhe shpresojmë të kryhet brenda llogarive të parapara dhe kohës së paraparë. Por ajo që mua më intereson posaçërisht është komenti i juaj z. Ministër, ku jeni me një master plan të zhvillimit të rrugëve dhe prioriteteve sipas studimeve të fizibilitetit dhe efekteve ekonomike dhe sociale, a kemi nevojë ne ta zhvillojmë një plan dhjetë vjeçar – pesëmbëdhjetë vjeçar lidhur me strategjinë e ndërtimit të rrugëve dhe korridoreve të rrugëve dhe t'i bëjmë prioritetet lidhur me to në bazë të efekteve ekonomike, sociale dhe me prioritet lidhur me korridoret pan evropiane, kjo ishte e para. Kurse, pyetja ime e dytë është, me intereson pasi unë po shoh se ju keni tentime që të diversifikohen burimet e financimit të rrugëve që mos mbetet vetëm buxheti burim për financim të rrugëve, prandaj kisha dashtë edhe një koment lidhur me atë se si po shkon kjo punë që ne të fusim më shumë burime të financimit për ndërtim të rrugëve, pak a shumë unë nuk isha këtu kur folët për hekurudhat është një çështje shumë me rëndësi, studimi i fizibilitetit për hekurudhat e Kosovës por në aspektin afatgjatë. Gjatë vizitës së fundit Kryeministri Rama në Beograd e përmendi hekurudhën, gjë që ishte pozitive për arsye se në vizitën e para një viti si Komision ne kemi qenë në Shqipëri dhe nuk kemi hasur shumë në entuziazëm për përkrahje në propozimet tona lidhur me hekurudhën por shpresojmë se Qeveria e Shqipërisë të ketë ndryshuar qëndrimet rreth kësaj çështje dhe ti jap prioritet kësaj hekurudhe se paku ne hartimin e studimit të fizibilitetit kështu që ndoshta edhe çështjen e hekurudhës e keni trajtuar këtu por unë shpreh keqardhje pasi mu deshtë mungoj nga mbledhja për pakë kohë.

Fatmir Rexhepi, e vlerësoj punën dhe informacionet që i dha ministri lidhur me menaxhimin e projekteve, pasqerë publike që gjatë këtij viti, së paku unë si deputet nuk kam dëgjuar as nga mjetet e informimit por as nga bisedat me koleg dhe të tjerë që të ketë pasur sikur që ka pasur trendë ndonjëherë që të ketë keqpërdorime dhe afëra të ndryshme. Prandaj, unë jap përkrahjen time të plotë që realisht të ketë mbikëqyrje të plotë dhe të jenë transparent dhe ti përmbahen kontratave pa e dhënë ndonjë shpjegim tjetër, në pamundësi që të flasim për mbikëqyrjen e kualitetit dhe shumë gjërave të tjera por të cilat nuk mund të ketë vërejtje por në këtë rast nuk ka mundësi me thënë asnjë fjalë, prandaj po e përkrahë atë si vlerësim pozitiv. Vërejtja ime parimore është se nuk lidhet direkt me ministrin aktual por prej kur jam deputet këtu por së paku nga viti 2008 në të gjitha raportet por edhe ne Komision çdo ministër që ka ardhur për të raportuar unë nuk kam pasur mundësi të dëgjoj ndonjë plan ose strategji tjetër, pos që është folur për autostrada për magjistrale po rregullohen në drejtim të veriut, në drejtim të perëndimit, në drejtim të jugut. Të gjithë ministrat e keni harruar që Kosova i ka $\frac{1}{4}$ në lindje të Kosovës pra për 8 vitet e kaluara, kjo lidhet edhe me fjalën e kryetarit që përmendi master planin, dhe, unë mendoj që është një padrejtësi e madhe në lidhje me planifikim dhe me strategji të ndërtimit të

këtyre magjistrave nuk po diskutoj për autostradën është diçka tjetër por magjistratet të cilat i lidhin regionet e tjera, është tepër vonë që nuk është ndërtuar edhe në pjesën regjionale të pjesës lindore që të lidhen edhe me Luginën e Preshevës, thjeshtë do të ishte me interes për të gjithë kombin pra është fjala për magjistratën Prishtinë – Gjilan. Një tjetër pyetje për ministrin, janë dy gjëra që kanë nevojë të sqarohen që mundet edhe para Parlamentit të sqaroj transparencën që edhe ma tutje është mjegull dhe që ka mbetur peng që nga viti 2008 e këndej lidhur me kontratën për autostradën, qoftë ajo që është bërë në 2008 nga Fatmir Limaj, qoftë kjo që keni vazhduar ju tani nga viti 2014, pra është mirë të na jepni informatë. Parlamentit mos me ditë për këtë projekt dhe mos me ditë kontratën kjo është për mua e papranueshme ka qenë dhe vazhdon të mbetet, nuk është hera e parë dhe as nuk jam i pari deputet që po e ngrii këtë problematik por kem nevojë ta dijmë herët apo vone. Çështja e transparencës, pyetja ime për ministrin është: pse po e lejoni dhe nuk po i drejtoheni Kushtetutës për çështjen e kontratave të mëhershme, monopoleve 8 vite janë nënshkruar kontratat, 10 vjeçare, dhe nëse janë antikushtetuese pse jeni vonuar dhe pse nuk keni kërkuar nga institucionet relevante që juve ju ndihmojnë, shembull e kemi kontratën e homologimit të veturave, a është apo nuk është monopol? Duhet ta dijmë nëse është tregona që është nëse nuk është na e thuani se nuk është, prandaj, Kushtetuta ka ekzistuar edhe atëherë kur është nënshkruar kjo kontratë, është ekonomi e tregut të lirë nuk guxon të ketë monopol dhe nëse është në kundërshtim me Kushtetutën është dashur të prishet ajo kontratë, pavarësisht se kush duhet të kërkoj llogari ndaj kujt.

Kryetari, fjalën e ka anëtarë Rrustem Berisha.

Faton Topalli, unë e dua fjalën kur e kërkoja isha i dyti me radhë, dhe dua të ma japësh fjalën sepse nuk ke të drejtë.

Rrustem Berisha, falenderoj z.Ministër për raportim, unë kisha dashur që ti ngrisë disa çështje rreth planifikimit të buxhetit për vitin e ardhshëm. Është një dukuri jo fortë e mirë që po na përcjell po thuajse çdo vitë se punët më të mëdha po i lëmë në gjashtë mujorin e dytë ku të gjithë e dijmë se në muajin shtator fillonë prishja e kohës dhe realizimi është shumë i vështirë, dhe nuk di a e keni vlersuar këtë në qoftë se jo kishte me qenë mirë që në gjashtë mujorin e dytë se paku 70% të buxhetit është i paraparë për Ministrinë që të planifikohet me qëllim që të shfrytëzohet koha e mirë për ndërtimin e rrugëve. Ndërsa, çështja e dytë ka të bëjë me sinjalizimin e hekurudhës sidomos Zahaq – Pejë, nuk ka asnjë vitë kalendarik që aty nuk pësojnë qytetarët që nuk ka aksidente me pasoja të rënda edhe pse nuk ndërmerret diçka që mu rregulluar e me u vendos një ramp ose një sinjalizim aty me qëllim të parandalimit. Çështja tjetër ka të bëjë me rrugët, rruga p.sh. hyrje dalje në Gjakovë në drejtim të Prizrenit, në drejtim të Prishtinës, Pejës nuk e kam as në këtë vitë që e potencuat si prioritet edhe sa unë kam informata realisht edhe nga kryetari më herët edhe tashë që ka pasur projekte për me u rregulluar hyrja në qytet, në Prizren që edhe tani në Pejë po rregullohet, por në Gjakovë kishte me qenë mirë që edhe të përfshihet Gjakova me rregullimin e hyrjeve në qytet. Ajo çka më ka bërë përshtypje është tek kualiteti i rrugëve une nuk e di se si është situata e mbikqyrjes te ju por në të vërtetë është tmerrë kur rrugët e reja pas një kohe shumë të shkurtër fillojnë me u prishë. Edhe pyetja tjetër ka të bëjë me rrugën Batush - Koshare, a do të përfundojë sivjet apo jo?

Faton Topalli më falni z.kryetar deshta me pyet se në bazë të cilit nen të Rregullores së Kuvendit se deputetit i cili nuk është anëtarë i Komisionit nuk mund të flas për para anëtarëve të Komisionit?

Kryetari unë e jap fjalën.

Faton Topalli unë po dua fjalën kur e kërkoja isha i dyti me radhë, dhe dua të ma japësh fjalën sepse nuk ke të drejtë të ma mohosh.

Kryetari ok pra merre fjalën...

Faton Topalli jo tash nuk po e dua, por më tregoni se në bazë të çkafit nuk kam të drejtë, më thuaj me cilin nen të Rregullorës së punës së Kuvendit ka drejtë anëtari që nuk është pjesë e Komisionit e që është deputet e që nuk është anëtar i atij Komisioni, apo ndoshta është çështje se nuk doni të ja japni fjalën opozitës pa asnjë rregull dhe si ministër i ish Jugosllavisë ti nuk ke të drejtë me ia mbyll gojën opozites, dhe kur është fjala për Kuvendin e Kosovës nuk ke të drejtë me ia ba kështu! Këtë që të lutem, këtë ta kesh parasys.

Muhamet Mustafa unë të thash se pas z.Grainca do e marrësh fjalën në qoftë se nuk ke durim me pritë atëherë mos prit, kështu që mësohuni me e respektu rendin.

Blerim Grainca, ministri ngriti disa çështje mjaftë interesante edhe unë e përgëzoj për punën të cilën ka bërë për aktivitetin e deritanishëm për transparencën në raport me Komisionin të cilën e ka pasur kam disa çështje për të ngritur që do të doja ti potencoj dhe që mendoj se janë interesante për të gjithë të pranishmit këtu. Është fol dhe është diskutuar shumë për investimet kapitale, investimet strategjike që janë bërë por ajo e cila po më bie në sy, shifrat të cilat i paraqiti z.ministër që janë 190 milion investime kjo po më jep një shpresë për koston e investimeve për arsye kjo nënkupton se përgjatë këtij prezantimi është bërë hulumtim për ulje të kosos për kilometer katror, për kilometer gjatësi që realisht i bie që kemi një menaxhim me standarde dhe suaza të çmimeve normale të tregut që në krahasim me ato informata që i kemi pasur në të kaluarën dhe për këtë e përgëzoj z.ministër. Dhe, përveç investimeve ka qenë edhe kostoja e mirëmbajtjes apo mirëmbajtja e koston dhe të investimeve që janë bërë, prandaj mjafton që të bëjmë investime dhe ato të mos nënvlersohen dhe të mos kemi jo efikasitet në mirëmbajtje. Të gjithë e dijmë se na ka ndodhë të ndëgjojmë komente banale në të kaluarën si p.sh “na zuri në dhjetor bora pa përgaditur”, dhe ka ndodhur shpesh që në muajin dhjetor në periudhën e dimrit ka pasur komente se “ra borë pa prituri” dhe se Ministria ose Komuna janë të pa përgaditura për mirëmbajtjen e rrugëve. Ju inkurajoj që këtij projekti ti jepni shumë rëndësi edhe për investimet ndërsa mua më intereson veçanërisht lidhur për dy autostradat Prishtin-Gjilan edhe Gjilan –Prishtinë për arsye që lidhen me këtë pjesën lindore veçanërisht me mundësinë që kanë Presheva dhe Bujanovci, pastaj pjesët e tjera të lidhura me Kosovën. Tek pjesa e hekurudhave unë ju inkurajoj veçanërisht për këtë studimin e fisibilitetit, dhe unë them se kishte me qenë mirë se do ishte më mirë që ti përshpejtojmë gjerat paksa me qëllim të finalizimit të tyre në mënyrë sa më efikase. Sa i përket transportit rrugor dua të ndaj me ju një shqetësim që lidhet me një vendim të qeverisë të Republikës së Shqipërisë të vitit 2015 që ka të bëjë me kufizim të sasisë së derivateve që mund të bartin autobotet gjegjësisht autobotet apo të gjitha makinat e rënda në rrethim Kosovë-Shqipëri në të cilin udhëzim kufizohet sasia me 200 litra

maksimumi e që mendoj se është një kushtzim jo real, dhe Qeveria e Shqipërisë i obligon kompanit transportuese të Kosovës që naftën ta blejnë në territorin e Shqipërisë e jo në territorin e Kosovës. Mendoj se kjo është një gjë e cila do të duhej ta diskutonin në raport me Ministrinë e Transportit të Republikës së Shqipërisë . Dhe kjo përveç që është një shkelje prej Ministrisë është edhe një shkelje për qarkullim të bizneseve kosovare dhe ju lus që me emergjencë ta diskutoni sepse ka shumë ankesa nga komuniteti i bizneseve. Tek pjesa e inspektorateve z. ministër unë ju përgëzoj megjithatë unë kam disa shqetësime lidhur me operimin e kontrollave teknike veçanërisht në të gjithë republikën e vendit tonë ka qenë një praktik në të kaluarën që shumë atumjeteve do i jepet leja e kontrollit teknik pa shkuar ta bëjë fare kontrollen teknike, fatkeqësisht kjo mund të përsëritet në raste të caktuara në të ardhmen.

Kryetari, deputeti Topalli, tani po e lexoj Rregulloren e Kuvendit, dispozitat e kryetarit të komisionit zbatohen në përshtatje me dispozitat e autoritetit të kryetarit të Kuvendit, neni 85 kur gjatë zhvillimit të mbledhjes parashtohen dispozita për interpretim dhe zbatim të kësaj rregullore është në kompetencë të kryesuesit të mbledhjes për të vendosur për pretendimin e parashtruar, vendimi i kryesuesit nuk është objekt diskutimi dhe kontestimi gjatë mbledhjes, z. Topalli e keni fjalën.

Faton Topalli, faleminderit shumë por nga ato që lexuat nuk shkruan askund se deputeti i cili nuk është anëtar i komisionit nuk ka drejtë më diskutu dhe shpresoj se nuk do të ma nderpreni fjalën.

Kryetari, nuk ju nderprej fjalën nëse jeni në temë, nëse nuk jeni në temë do t'iu nderprejë.

Faton Topalli, ky rast tregon edhe një herë se pavaresisht a ka të drejtë apo jo pozita është në gjendje me shkel opozitën, bile kërcënim i parë është edhe sigurimi.

Kryetari, kaloni në temë.

Faton Topalli, unë do të kaloj në temë, sa përket kontratës për autostradën Prishtinë - Hani Elezit ju keni hapur dyert e ministrisë për pak orë që kush ka dashur ka mund të vijë aty, por nuk kemi akoma asnjë kopje të kësaj marrëveshje, pyetja ime është se a mund të na silleni një kopje të kësaj marrëveshje qoftë edhe në këtë komision, që deputetët ta kenë si kopje? Pyetja tjetër është se sa prisni që të jetë vlera e punëve shtesë për këtë projekt dhe si i llogaritni punët shtesë? Ju përmendet autostradën Besi – Merdar, a mund të na thoni se sa është çmimi i kësaj autostrade? Pyetja tjetër është për Bektel Enka, kompanitë vendore në përgjithsi ankohen për mardhëniet jo të mira me Bektel Enka në disa raste kanë nderprerë kontratat e punës duke mos pasur mundësi financiare për ta vazhduar aktivitetet, në mediat vendore është raportua se nga pesëmbdhjetë nga kompanitë vendore kanë ndërprerë punimet në rrugë, ndërprejet vijnë si shkakë të presionit nga Bektel Enka për ti ulur çmimet për ti bërë më të ulta. Sipas kompanive vendore institucionet e Kosovës nuk e kanë mbikqyrë kontratën në masën e duhur dhe si rezultatë i kanë dhënë liri të plotë kontraktorit kryesor të eksplatoj resurset vendore, a jeni në dijeni për këto probleme dhe çfarë keni bërë për ti ndaluar abuzimet nga Bektel Enka? Ju kamë shtruar gjithashtu një pyetje parlamentare për sa ju përket puntorëve Rumun që janë duke punuar në këtë kompani kemi informacione që janë rreth 100, minisitri i punëve të brendshme thotë se nuk jemi në dijeni që ka

punëtorë nga Rumania, ju thoni që nuk kemi dijeni, jo në fakt ju keni deklaruar se nuk e dini se çfarë punëtorë ka aty, mirëpo, këtë qështje duhet ta dijë ministri i punëve të brendshme. Ndërsa, për neve është me rëndësi të dijme se punojnë apo nuk punojnë punëtorë të huaj për arsye se kemi një papunësi jashtëzakonisht të madhe në Kosovë. Sa i përket qështjeve të hekurudhave, ju folët sa i përket hekurudhës së Hanit të Elezit – Leshak, keni deklaruar se është ndërprerë puna për parakualifikim, a ka pasë studime të më herëshme të fizibilitetit lidhur me hekurudhën dhe cila kompani i ka bërë ato? Dhe, sa i përket kontrollit teknik është shtruar homologimit të vetuarve është shtruar kjo qështje edhe nga kolegë e tjerë kjo kontratë është nënshkruar për përidhën 2009-2019 është bërë pa tenderim dhe pyetja ime është a mundë ta sjellni një kopje të kësaj kontrate që ne si deputet ta shohim përmabtjen e saj? Këto janë pyetjet që deshta ti shtroj zotit Mustafa, nuk janë armiqësore janë në shërbim të transparecës, janë në shërbim të qeverisjes të mirë.

Krytari, komenti është i tepërt, këto tjerat i refuzoj dhe fjalën e ka Raif Qela.

Raif Qela, kjo ministri padyshim që ka bërë punë të madhe gjatë këtij viti edhe në përputhje me vijat buxhetore që ka pasur. Pyti se aty ku nuk ka marrëveshje kontraktuale a ka mundësi të rishikohen prioritetet që në mënyrë që disa nga projektet që janë të mëdha të reduktohen në dobi të disa projekteve më të vogla, që mendoj janë në interes më afatëgjatë që janë në interes të qytetarëve të Kosovës. Në rendë të parë mendoj se disa prej rruëgve që na lidhin më pjesët e veçanta të qytetarëve shqiptarë jashtë Kosovës si rruga Deçan – Plav, sepse dihet mirëfilli që ndihmon rendë në izolim të atyre qytetarëve atje dhe pastaj e zhvillon turizmin malor. A ka ndonjë mundësi buxhetore që të vazhdohet rruga prej Koshtovës, respektivisht të vazhdohet rruga në drejtim të Trepçës, sepse mjaftojnë vetëm edhe 5 km asfalt dhe të lidhet edhe pjesa tjetër e rrugës prej Trepçës që lidh fshatrat Koshtovë dhe Bistricë. Sepse ato fshatra sidomos kur nuk ka siguri janë krejtësisht të izoluara, pastaj edhe disa prej projekteve të vogla që lidhin me pjesën e Kosovës lindore të cilat po ashtu njëra prej cilën e përmendi edhe deputeti Rexhepi, sepse një pjesë padyshim edhe po të orientohet autostrada në drejtim të Preshevës apo Bujanovcit, është me rëndësi afatëgjate dhe shumë të madhe për ne qytetarët e Kosovës edhe për shkak që lidhjet familjare dhe lidhjeve të tjera. Pyetja tjetër është se e përmendet më duket se deri ku ka arritur qështja e testimit të kandidatëve për patent shoferi online, por dua ta di përfundimisht se deri në cilin afat mendoni se do të fillojë testimi i kandidatëve online? Besoj se do të ndikojë shumë në mirë pasi që dihet se një pjesë e madhe e patent shëferëve janë marr pa meritë dhe si pasojë e kësaj kemi shumë pasojë në trafik edhe materiale edhe në njerzë.

Kryetari, deputetja Duda Balje, mandej kemi deputetitin Enver Hoti, deputetja Sala Berisha – Shala dhe mandej Besim Beqaj nese don, urdheroni deputetja Duda Balje.

Duda Balje, kemi dëgjuar shumë informata të cilat unë nuk i kam ditur. Unë kam dy pyetje, pyetja e parë prej dy pyetjeve ka të bëjë me kalimin kufitar konkretisht drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë, kalimin kufitar me Strezimirin, janë të nevojshme edhe disa mjete shtesë në komunë që kjo të kryhet, me rëndësi të veçantë për rrugën e qytetarëve në mes Maqedonisë e Kosovës. Dhe e dyta qështja diskutabile e komunitetit boshnjak në komunën e Prizrenit – vendi Gryka e turkut (Turska krisura) për të cilën mendoj që është vend i rrezikshëm momentalisht, kjo

është pjesë e rrugës kur shkohet prej Prizrenit drejt Shtërpçës, shumë është frekuentuese, posaçërisht gjatë vikendeve dhe frekuentimi i qytetarëve prej Zhupes drejt Prizrenit, çdo ditë kanë ndodhur disa incidente, unë e di që ky është projekt i madh, por unë ju lutem nëse ekziston mundësia financiare që të ndahet në faza dhe të fillohet me realizimin e tij dhe zgjidhjen e këtij problemi.

Kryetari, fjalën e ka deputeti Enver Hoti.

Enver Hoti, dëgjuam disa informacione të rendësishme po mendoj që nuk ishte keq që një ditë më herët të na sjellni materialin. Disa pyetje, p.sh me prezentimin tuaj aq sa mundëm me kapë ne në rrugën p.sh Kijev – Zahaq, thatë se keni zgjedhur altrenativën e re sipas jush, në shifra e ka një diferencë mes asaj 30 milionë, ndoshta kam një pyetje konkretë këtu, cila është kosto e shpenzimeve? Nëse e leni në këtë segment a e rrit kosoton ende këtij 160 milionit për Qeverinë, spo flas vetëm për si rrugë. I paraqitët disa vërejtje disa të dhëna interesante për pjesën Gjurgjicë- Kjevë, një rrugë 8 km që ka metë aty si “viran” që sa vite mbi 17 milion euro, thatë që po kushtojnë, është një rrugë që ua kish lehtësu jetën atyre banorëve të asaj pjesë. Kam një pyetje konkrete, a ka diçka shtesë me u pergjigjë kërkesave të këtyre banorëve përtej nënkalimeve sepse ata kanë edhe një kërkesë siç e dini edhe për disa shirita anësor që ndihmonë është konstatuar mendoj edhe nga Instituti GAP. Për çështjen e homologimit që është konstatuar dhe është evidente ajo dhe besoj se e pranoni se ka një monopol aty siç e tha edhe deputeti Rexhepi dhe unë po u a përseriti ku gjendeni tani në atë porces se çfarë keni ndërmarr dhe a jeni gati për ta përfunduar dhe kush po ju pengon? Investimet në kohë elektorale që nga viti 2010 e këndej kam shpresuar që do ta nderpreni, mirëpo ajo po vazhdon mendoj se është një izolim që po i bëhet disa njerëzve të pa drejtë kam dhjetra projekte që kanë mbetur pa realizuar nga komuna e Malishevës, dhe sinqerisht është vetëm një projekt që përfshin 160.000 mijë euro dhe nuk po përmbushet. Nuk po e di se cili kryeminsiter po të pengon a zoti Mustafa a zoti Veseli njëri po, se dy i ki por cili po të pengon? Veç mendoj se është goditur padrejtësisht që nga viti 2010, se po bëhet një padrejtësi.

Kryetari, faleminderit, tani fjalën e ka deputetja Sala Berisha – Shala.

Sala Berisha – Shala, tha e falënderoi ministrin për këtë raport, unë i bashkëngjitëm kolegut parafolës, ndoshta ka qenë mirë që këtë raport ta kemi paraprakisht.

Kryetari, sigurisht lidhur më këtë ne mund ta bëjmë praktik në të ardhmen, por deri tani kur i kemi thirrur për raportim ministrat, kanë raportuar këtu nuk kanë dërguar raport më shkrim përpara, po të ardhmen ne e bisedojmë formatin. Urdhëroni deputete,

Sala Berisha - Shala, natyrisht deputetet e orientojnë debatin, lidhur më zonën prej nga vijnë, që është mirë të dijmë se si qëndron situata në infrastrukturën rrugorë dhe hekurudhore, e kështu më radhë. Mendojë që rëndësia e projekteve, nuk qëndron vetëm në kilometra, dhe nuk qëndron në koston e tyre, po qëndron në atë se në çfarë funksioni është e shtruar ajo rrugë dhe sa është në përdorim dhe ofron shërbime për qytetarët e Kosovës. Pyetja ime është për projektet që po zgjasin më vite çka është ndërmarrë në këtë drejtim siç janë projektet në drejtim të Mitrovicës, mandej projektet Skenderaj – Drenas ? Sa përket rrugës Skenderaj - Komuran, e kam shtruar

edhe një pyjet parlamentarë, që ministri, kryesisht më është përgjigjur atje, e kisha shfrytëzuar rastin që ministri të ma jep një përgjigje pak më detal. Mendoj që rruga Skenderaj - Komoran është një arter e rëndësishme që lidh pjesën veriore të Kosovës më pjesën qendrore të Kosovës. Për shkak të kësaj rëndësie dhe rendësi së projekteve tjera realizimi kësaj rrugë ka mbetur që nga mandati i kaluar e dijmë që ka pengesa, nga përgjegjësia e ministrit në seancë plenare me tha ka problem më shpronësim të pronave. Më aq sa kam informacion këto problem kanë qenë në pjesën Skenderaj deri në fshatin Morinë, mirëpo Morinë - Komuran nuk është bërë as një hapë përpara dhe në atë pjesë, nuk ka probleme të shpronësimit. tani ku po qëndron problemi dhe në çfarë fazë është tani ky projekt? Në mënyrë që ajo pjesë e buxhetit e paraparë në zgjerim të atijë segmenti të mos shkojë në suficit, po të hyjë në funksion të asaj rrugë e cila është e paraparë. Lidhur me Strategjinë e Sigurisë në Komunikacion, sa mjete janë ndarë për këtë strategji dhe sa po zbatohet kjo strategji? E përgëzoi ministrin, që menjëherë ka hyrë në zbatimin Ligjit për Patentë Shofer që janë marrë hapa edhe efektet këtij Ligji dhe shihet që janë pozitive. Po ashtu edhe për Ligjin për Rregullat e Sigurisë në Trafik, edhe pse ka pas zëra që nuk mund të jetë i zbatueshëm, analizat e para kanë dalë që ligji është duke gjetur zbatim në sigurinë e trafikut.

Besim Beqaj, tha u ngritën shumë çështje edhe të karakterit nacional të rëndësisë së rrugëve dhe karakterit lokal që është më interes për qytetaret, normalisht ministra si e tillë është përgjegjëse për realizimin për rrugët edhe për procedurat të cilat do të ndodhin. Në bazë informacioneve që kam, kemi ngecje goxha të madhe në realizim të buxheteve në shumë projekte, po ja nis prej projektit të Mitrovicës që është më Bankën e Islamike edhe më institucionet tjera, është viti i pestë (5) prej kur është nënshkruar marrëveshja, 5 vite më sa di unë është greis periudha, edhe besoj që vitin e ardhshëm duhet më fillu më paguar kredinë, ndërsa, më sa di asnjë aktivitet nuk ka filluar, mendoj së është çështje shumë serioze që duhet të diskutohet. Sepse qytetaret nga fillimi i viti duhet më buxhet më pagu kistin e parë për këtë rrugë, janë 60 milion të huazuara edhe që pse 5 vite mos më ndodh as një aktivitet diçka nuk është në rregull. E njëjta procedurë është që kanë të bëjnë më rrugën Skenderaj – Drenas, në bazë të informacioneve që kemi është një ngecje esenciale në realizimin e buxhetit, duhet të them së as ministria e infrastrukturës nuk është krejt pa përgjegjësi, sepse kemi ngecje të procedurave edhe pse nganjëherë tentojmë që kjo të adresohet në nivel komunal, nivele komunal janë disa segmente, por e dijmë së çështja e shpronësimit fillon nga ministria për Mjedis dhe Planifikimit Hapësinor, elaborati për shpronësim bëhet Ministri të Financave, e pastaj kjo çështje zgjedhjet edhe më bashkëpunim edhe më komunat, në këtë drejtim besoj që duhet të jeni shumë më të koncentruar në mënyre që të a jepmi efektin e vet. Unë po i shohë nga një herë që ministrat po kthehen në retrospektiv, por është kohë e mjaftueshme edhe më kthyer gjerat në aspekt aktual që u ceken. Një segment tjetër që është shumë problematik edhe që ka problem të sigurisë në rrugë është segmenti i rrugës Prishtinë – Pejë, e kam bërë edhe dy herë këtë pyetje të njëjtë, sa i përket urës në Llozicë, përveç që kemi ngecje, tani po shifet një punim i lodhët, kuptimin e angazhimit ditor, një urë e nivelit të tillë mund të kryhet shumë shpejt, është esenciale, as nuk ka shenjzim të mirë kemi goditje të caktuara edhe kjo vazhdon deri në Pejë. Pjesën nga Zahaqi deri në Pejë rruga është duke u punuar por siguria është tmerr, ka gropa që çdo shofer mund të ketë pasoja fatale për të. Problem tjetër është mirëmbajtja e autostradës në drejtim të Shqipërisë, heqja edhe shumë dilemave edhe pse jo edhe të pikave të shtijës së karburanteve edhe gjërave të tjera të cilat janë të parapara, këto janë çështje të aspektit të zhvillimit ekonomik, sepse nuk mund bëjmë kufizime bizneseve, sepse kur është projektuar autostrada, është projektuar që më pas edhe pika të shtijës së karburanteve dhe pika pushim që do të kishin efekte ekonomike dhe kjo nuk po ndodh, janë gati

2 vite e gjysmë. Kur do të filloni rrugën në segmentin ku përfundon në Babush? Pastaj kur duhet më u leshu në qarkullim? Sigurinë në fushën e hekurudhave e keni problem e dijmë që tani ndërmarrjet tona në Kosovë kanë filluar më paguar penalti të mëdha, si ndërmarrja Trankos-it ka dënime mbi 200.000 si pasojë të ankesave të njerëzve të cilët kanë humbur jetën për shkak të mos kujdesisë dhe pa sigurisë nga kjo ndërmarrje. Pavarësisht projekti që ka të bëjë me BRZH-in ajo do të shkoj edhe pak kohë. Andaj do të ishte shumë mirë të koncentrohemi në aktivitete të cilat ndërlidhën drejtpërsëdrejti me një qeverisje të mirë të buxhetit, duke i shtuar edhe elementin transparencës së buxhetit në shpenzime, por gjithsesi duke ruajtur aktivitetin e ndërmarrjes të cilin funksion janë. Po themi këtë se nga një herë kemi krijuar një përshtypje së çdo gjë që është në sektorin privat është keq dhe në tregun e Kosovës janë mbi 85% janë të punësuar në tregu privat, edhe që mbi 70% e buxhetit janë nga të hyrat e sektorit privat që mblidhen nga 200 deri 250 ndërmarrje. Edhe të zgjerim rrugëve këto pengesat që po hiqen nuk e kam kuptuar saktë pse deri të HIB-i më u hekë por nëse veç niste një procedurë duhet përfundohet, nuk e kam pas të qarte asnjëherë pse kjo po bëhet ashtu, a është çështje llotve të caktuar? Por është elemente jashtëzakonisht i sigurisë, një elementë tjetër që kam vërejtur është dhe kërkon goxha analiza është rrethi në hyrje të Prishtinës tek FSK-ja, nuk e di kuptimin profesional por besoj që në ndërkohë ka më pas aksidente të mëdha.

Kryetari, faleminderit shumë kolegë për pyetjet e shumta, natyrisht që ne i kemi bërë shumë pyetje ministrit dhe kjo tregon që kur është fusha e gjërë ka edhe pyetje shumë. z. Ministër kërkoj nga ju që të përgjigjeni në pyetjet e deputetëve.

Lutfi Zharku, faleminderit kryetar dhe ju deputet, e para sa i përket një masterplani për zhvillim të rrugëve natyrisht nuk e kemi, të gjitha këto vendosen si prioritet qeveritare por që nuk kemi asnjë masterplan, natyrisht që jam i interesuar që ta kemi një plan të të gjitha rrugëve dhe përfundimisht ta kemi një afat kohor se deri kur mund t'i kryejm projektet e infrastrukturës rrugore. Rrjeti bazë është i definuar me marrëveshjen e Berlinit që përfshin zgjatjen e rrjetit bazë Panevropian në Kosovë e që janë katër rrugë, në këtë kuptim janë dy rrugë, hekurudha, është autostrada Ibrahim Rugova, autostrada Arbër Xhaferi dhe është hekurudha linja 10 prej Leshakut – Hani i Elezit, si dhe është Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Financimi i jashtëm, po mundohemi për vazhdimin e segmentit Besi- Merdarë që ta kryejm me financim të jashtëm, ende nuk e kemi të saktë nga ana e Komisionit Evropian se sa do të jetë granti, pjesën tjetër do ta kryejm me financim të jashtëm, dy institucionet baze edhe Banka Evropiane Investive edhe Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim janë të interesuara deri tani. Përveç kësaj është rruga Kijevë – Pejë 32 km, do të vazhdojmë më investim të jashtëm, kemi rrugët hyrëse dhe dalje ne Prizren, në Mitrovicë po ashtu në Ferizaj dhe Gjilan si dhe rrugën Kllot – Gjilan e kemi me financim të jashtëm dhe natyrisht hekurudhat. Vërejtje kemi, po e marr si shembull tek rruga Kijevë – Zahaq, një vit para se ta marr pëstën e ministrit ka filluar kjo rrugë, une i bëra gati dy vite në udhëheqje të kësaj ministrie dhe ende jemi në procedurat kur duhet me u nënshkruar marrëveshja, e kam paraqit si problem edhe te Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim edhe tek Banka Investive Evropiane. Vitin e kaluar ne kemi arritur që për tre muaj ta bëjmë një marrëveshje prej 29 milion euro për rrugët hyrëse dhe dalje në Prizren, Ferizaj, Gjila dhe rrugën Kllot – Gjilan por që një vit jemi në disa procedura para kualifikimit që është përmbyll me 30 qershor, ende nuk e kemi nga ana e BERZH-it konfirmimin që është pa vërtetë, që ta vazhdojmë fazën e kualifikimit dhe disa kërkesa që dorën në zemer janë të vështira, p.sh. nëse e financonini prej BERZH-it ata kërkojnë në përpunje me rregullat e tyre që duhet me u paguar kompensimin

edhe për një pronë apo ndërtim që është pa leje. Sa i përket magjistrales apo autostradës së re për Gjiçan, ne i kemi përfunduar, projektii është i kryer jemi në fazën e të hartimit të elaboratit të shpronësimit, shpresojmë që në vitin e ardhshëm që me mjetet që parashihen prej AKP-së, së paku 80 milion euro, që të fillojmë në vitin e ardhshëm me këtë autostradë edhe pse kjo është çështje me e lartë e vendimmarrjes së ministrit. Çështja e transparencës së kontratës për autostradë, kontrata aktuale është e qasshme për të gjithë ata që deshirojnë ta shohin, e di që edhe në kohën kur e ka nënshkruar ish ministri ka pasur një ditë që ka mundur të shkojë dhe ta shohë çdo kusht që ka qenë i interesuar kjo është në përputhshmëri edhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare.

Kryetari, homologim për çka, çka është ajo private a publike, interesant qenka, çka a ka investuar a çka ka dhënë?

Lutfi Zharku për QAK-un, Qendra për Automjetet e Kosovës është private, është marrëveshje 10 vjeçare, si ministri apo sot e shpreh është shpreh një raport biznesor, unë nuk dua të paguaj ministrin as qeverinë të paguaj penale shkaku i asaj marrëveshje, ju e dini që qeveria ka marrë vitin tjetër vendim për eliminimin e monopoleve dhe të gjitha barrierave të tjera në treg.

Fatmir Rexhepi a është kushtetuese apo është antikushtetuese, unë e bëra pyetjen shpesh. Nëse është anti kushtetuese marrëveshja që nuk vjen d.m.th në kuadër të ligjeve të Kosovës, është e drejtë e qeverisë me shkëput atë dhe nuk ka penalitet. Në qoftë se është kushtetuese unë kam qef me kan....

Lutfi Zharku, unë nuk jam i autorizuar të tregoj se a është çështje kushtetuese apo nuk është kushtetuese, është dhënë udhëzimi administrativ që është hartuar në atë kohë për futjen në atë udhëzim, tash të gjitha problemet e tjera ligjore që janë unë besoj se institucionet kompetente duhet me dhënë atë mendim.

Fatmir Rexhepi, unë edhe një herë po reagoj se kam me dhënë deklaratë se a është antikushtetuese monopoli a është kushtetuese pikë. Po e dua vendimin e qeverisë, unë spo akuzoj, po kërkoj në qoftë se jemi normal duhet me luftuar monopolin.

Kryetari, ministri na dha përgjigje në kemi edhe Komisionin e Konkurrencës, në mund atje të parashitjmë këto pyetje dhe kërkojmë prej autoriteti ta hulumtoj këtë punë.

Lutfi Zharku, sa i përket pyetjeve që i tha z.Berisha për planifikim e buxhetit na kanë ndarë hartimin e buxhetit në dy pjesë të vitit, po flas prej përvojës të vitit të kaluar kemi një problem në rregullimi është më i madh dhe më i lartë në pjesën e dytë të vitit, është më i lartë të kompanitë vendore, ku fillon me 1 prill ndërsa shumica e kompanive nuk mundën me u përgaditë por fillojnë ka fundi i prillit eventualisht nga maji, do duhej të rregullohej me gjithë. Një po flas prej përvoje që sezona, që pjesa e dytë e vitit është më e fortë në ndërtim se pjesa e parë kështu që ndërtimet apo sezona vazhdon në kuadër të asaj pse është dashtë të përfundohet me 15 nëntor është dashtë me përfunduar në përputhje e varësit prej kushteve atmosferike. Sinjalizimi i hekurudhës Zahaq-Pejë, të sinjalizimi natyrisht është çështja e hekurudhës është pjesë ekskluzive e Infrakosit nuk

është e jona përpos në raste kur na kemi drejtë për drejtë kur kemi kryqëzime në rrugë. Të hyrjet dhe dalja e Gjakovës, unë projekte nuk kam pasur deputet asnjëherë, nuk kam pasur si kërkesë që dy vite që po flas kemi pasur kërkesë zyrtare të jemi të sinqertë, shpesh që rrijmë me cilin do kryetar apo deputet që flasim mbi projektet e nevojshme mirëpo kërkesë zyrtare nuk kam pasur. Rruga Batush – Koshare, sipas kontratës duhet të kryhet vitin e ardhëshëm, ne kemi bërë të gjitha përpjekjet dhe presion që rruga Batush - Koshare të përfundohet mbrenda këtij muaji. Deputetit Grainca, mirëmbajtja rutinë dhe mirëmbajtja kapitale, më shumë problem kemi të mirëmbartja kapitale që na tash po flasemi themi drejtë pasi që jemi pjesë e institucioneve nuk i kushtohet rendësi e posaçme mirëmbajtjes kapitale të rrugës por që është mungesë e buxheetit sipas standarteve të BE investimet në rrugë dhe investimet në mirëmbajtje duhet të jenë 10% - 15% të investimeve. Autostrada Prishtinë - Gjilan – Ferizaj kemi rekonstruktime substanciale të pjesës Klllokot - Gjilan dhe tash do të fillojmë për vitin e ardhshëm nëse munemi për zgjerimin prej urës deri te kyqja, në mënyrë që të përgaditemi për autostradë. Udhëzimin administrativë të Republikës të Shqipërisë nuk e kam dhe kërkesë zyrtare prej asnjë kompanie nuk kam pasur. Operimi i kontrollave teknike jo kualitative, besojë se me udhëzimin e ri i kemi shtrënguar këto kritere dhe ligji i ri për automjete që do të vjen së shpejti. Deputet Topalli, hekurudhën Prizren - Prishtinë - Durrës bile është keq të themi se Qeveria e Kosovës ka insistuar shumë më shumë se sa ajo e Shqipërisë në takimet që nga filimi, nga takimet e para, që janë mbajtur nga marsi në vitin e kaluar, në kuadër të Samitit të Berlinit kushti i parë ka qenë se na duhet të zotohemi për sigurimin e mjeteve nuk ka para grante në projekte të themi shabllonë, të themi kështu paushall të marim projektin ta aprovojmë nuk ka pasur mbështetje nga Komisioni Evropian, Të njëjtën situatë e kemi pasur edhe në projektin për zgjerimin e rrugës prej Pejës në Podogricë, mirëpo Qeveria e Malit të Zi nuk ka mund me u zotu që do ti sigurojë mjetet për atë rrugë. Komuna e Prishtinës nuk diskriminohet, në realitet ne kemi disa projekte në Prishtinë, përkundër asaj jemi në fazën përfundimtare të harmonizimit të projektit për zgjerimin e rrugës prej Urës në Veternik, nëse mundemi për vitin e ardhëshëm deri të Gorenje ta shkarkojmë atë fluksë nga pjesa e Gjilanit apo kush do qoftë. Në pjesën tjetër kemi rrugën Zajqevc - Turiqevc që është dhënë nese nuk gaboje edhe tenderi që është kryer që nuk shoh diçka, nga njëherë krijohet disa ajo që e tha deputeti, investimet që i permendi edhe deputeti që kryhen rrugës nacionale llogariten se janë pronësi e Prishtinës.

Faton Topalli, komuna e Prishtinës nuk ka asnjë projekt investim të plotë që është bërë nga Qeveria në këto tri vitet e fundit, kur Vetvendosja është në qeverisje.

Lutfi Zharku, tani unë i permenda dy tonat, tani ju më shtini të them se kurr letër zyrtare apo kërkesë nuk është ardhur në ministri nga komuna e Prishtinës për të investuar një projekt.

Krytari, nuk kanë bërë kërkesa, ti i ke bërë dy projekte, tani nuk e kemi Prishtinën në rend dite

Faton Topalli, po e pyes ministrin...

Fatmir Rexhepi, nuk kanë pas vaktë o kryetar, kanë pas me protestu, skanë pas vakt me shkru letra.

Kryetari nuk e kisha deviju debatin protesta ç'protesta nuk kemi nevoj me folë për atë.

Lutfi Zharku nuk kemi pasur asnjë kerkësë zyrtare për financim ose diçka të tillë për ndihmë ndonjë rrugë këto rrugë që i kemi çmimi është 10 milionë në parim, por sillet çmimi pleminare 7-8 që kanë jap, marrëdhënjet jo të mira me kontraktorin Bektel Enka sikurs Bekteli me çfarë do kompanie qe ekziston. Ministria nuk guxon të ndërhyjë me marrdhenjet kontraktuale më të tjerë ato janë marrëdhënie tipike të tyre. Sa i përket numrit të punëtoreve, 1116 janë kosovarë, afër 500 janë punëtorë të jashtëm, sipas të gjitha raporteve dhe takimeve të mia që kam pasur për këtë çështje, jo tani kur ju e keni përmendur por më herët ata e kanë cekur se nga jashtë marrin vetëm punëtorë ose ekspert qe nuk mund të gjejnë në vendin tonë. Studimin e fizibilitetit për hekurudha në realitet ajo qe unë e kam përmendur, ne jemi marrë vesh që mos ta ndërpresim parakualifikimin por natyrisht me ngadalësuar pak deri sa t'i kryejmë procedurat për studimin e fizibilitetit, termat e referencës më kanë ardhur para dhjetë ditësh, Infrakosi dhe Njësia për Implementimin e Projekteve i kanë dërguar në BERZH, pas dhënies të disa komenteve nga ana e BERZH-i, besoj gjatë javës do të kryhen ato komente për termat e referencës dhe natyrisht do të vazhdojmë me studimin e fizibilitetit për nënkalimin në Ferizaj.

Faton Topalli, me fal kam një pyetje, kontrata qe keni bërë për rrugën Prishtinë – Hani i Elezit, a ka mundësi me ua siguruar një kopje deputetëve.

Lutfi Zharku, kur të doni ejani ne ministri dhe e shihni.

Kryetari, u përgjigj më herët, është e qartë përgjigjja.

Faton Topalli, a ka mundësi qe të na dërgoni një kopje fizike sepse është e rregulluar me ligj kjo çështje.

Lutfi Zharku, nëse është e rregulluar me ligje, të jeni të bindur se unë nuk e shkeli ligjin, nëse ligji ma lejon qe unë me ja sjellë marrëveshjen do ta bëj këtë.

Kryetari, z. Topalli ju duhet ta merrni fjalën që të mund të flisni, ministri u përgjigj dhe nëse mendoni se ka shkelje të ligjit ju mund ta paraqisni ne gjykatë. Ju lutem z. Topalli këtu është një mbledhje serioze dhe jo mbledhje çfarë jeni mësuar ju. Ju lutem vazhdoni ministër ju e keni fjalën dhe mos e ndërpreni ministrin.

Faton Topalli, kryetar mos u nervozoni shumë, e di qe opozita ju nervozon, tregohu me i sjellshëm, më parimor, qetësohuni e mos u nervozoni. Unë po kërkoj një përgjigje ne pyetjen time, z. Ministër a ka mundësi të na sjellni një kopje fizike të kontratës për rrugën Prishtinë – Hani i Elezit?

Lutfi Zharku, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare i keni të gjitha të drejtat.

Kryetari, deputet e morët përgjigjen, vazhdo ministër.

Lutfi Zharku, për deputetin Hoti, rruga Kijevë – Zahaq ajo që biseduam më herët i kemi kërkesa të gjithë banorëve të fshatrave aty jemi duke u munduar t'i zgjidhim dhe besoj se i zgjidhim të gjitha këto janë edhe investime shtesë që janë bërë por që nuk kanë qenë të parapara në projektin fillestarë dhe besoj se do t'i zgjidhim.

Enver Hoti, një pyetje shtese nëse bën, tek kosto e shpronësimit që keni zgjedhur aty dua ta di.

Lutfi Zharku, sipas studimit të fizibilitetit kostoja e shpronësimit është e përfshirë në këto shifra që i përmenda, nëse vazhdojmë me zgjerimin e rrugës aktuale parashihen rreth 17 milion euro shpenzime të shpronësimit kurse me rrugën e re me pak se 3 milion diku 2.7 ose 2.8 milion euro.

Blerim Grainca, po i kthehem edhe një herë kësaj çështjes së udhëzimit administrativ të Republikës së Shqipërisë, unë do të lexoj udhëzimin e bashkë me të edhe dënimet që i kanë shqiptuar organet e Shqipërisë në raport me bizneset kosovare, ku në njërën nga to thuhet: Shqiptohet dënim për arsye të naftës mbi limitin e lejuar.

Lutfi Zharku... për rrugën Prishtinë – Mitrovicë, kemi probleme mos të themi të komunikimit të kryerjes së punëve e të tjera, ne muajin qërshor e kemi kryer njësinë për implementimin e projektit e cila na është aprovuar pas 6 muajsh, kemi kërkuar funksionalizimin e njësisë së implementimit të projektit, po mundohemi të krijojmë një kategori për të filluar punën me ata. Për sqarim se paku mua kështu me është thënë që deri sa nuk paguhet një cent nuk konsiderohet që ështëhuaja kështu që ne momentin kur fillojmë me i shfrytëzuar atëherë konsiderohet ajo që na duhet për të paguar kosto, përndryshe për derisa nuk fillohet me i shfrytëzuar nuk e kemi problemin e pagesës. Drenas – Skenderaj është kryer ajo pjesa që e kam sqaruar në Kuvend, 17 vende janë me probleme pronësore, kemi biseduar me organet në Komunën e Skenderajt jemi dakorduar që të fillojmë në ato pjesë ku nuk kemi probleme. Prej Morinë – Komaran, tani e kemi kryer projektin, jemi në fazën e përcaktimit se në cilën pjesë të vazhdojmë, sipas disa vlerësimeve tona do të ishte mirë të vazhdojmë me llotin e ri prej Kronit të Mbretit – Ferronikel, ta kemi për vitin e ardhshëm në mënyrë që të lirohet kosto, do të shpallim tender besoj që gjatë këtij muaji do ta kemi edhe llotin e ri pavarësisht problemeve që i kemi në atë pjesë. Strategjia e sigurisë në komunikacion rrugorë, strategjinë e kemi por para nuk kemi, 70 000 deri në 80 000 euro në vit janë për çështje të aktiviteteve të strategjisë rrugore. E përmenda edhe linjën Prishtinë – Mitrovicë, Komaran – Skenderaj, Prishtinë – Pejë shënjestrimin do të shohim me kompanitë që t'i përmbahen strikt ligjit sa i përket sinjalizimit. Mirëmbajtja e autostradës, problemet që i kemi, shëmbjet që janë bërë kanë ndodhur pas kalimit të afatit garantues, ato shëmbje të dheut janë si pasojë e tri shkaqeve: gabimet në projektim, gabimet në realizim dhe se fundi e kemi pasur gabimet në mosmirëmbajtjen e duhur. Këtë vit e kemi bërë një vlerësim dhe do të shkojmë me një tender deri në gjysmë milioni euro për rehabilitimin e atyre pjesëve që janë shëmbur. Pikat e karburanteve, shpresojmë që deri në fund të këtij viti ta kemi shpalljen publike. Rrethi të FSK-ja, jemi duke u munduar të bëjmë një zgjidhje që ta zgjerojmë rrethin, pas diskutimeve të shumta kemi mbetur që të shqyrtojmë edhe një herë atë pjesë të projektit.

Faton Topalli, kam një pyetje, në vitin 2015 është folur për një investim 20 milionësh për zgjerimin e pistës së aeroportit, me intereson ta di a ka ndonjë vendim për këtë çështje?

Lutfi Zharku, ka qenë kërkesë nga viti 2014 nga ana e aeroportit, vetëm pistat janë 2500m, Maqedoni është 3000m, Tirana e ka pistën 2800 ose 2900m, të gjitha pistat në rajon kanë hapësirë me rreth 3000m në mënyrë që t'i jepen mundësi fluturimeve tejoqeanike në mënyrë me të lehtë. Janë kryer të gjitha analizat, është një vlerësim nga 30-35 milion euro investime, por për shkak të disa të KRPP-së. A duhet të trajtohet si punë shtesë apo duhet të trajtohen si projekt i ri kanë mbetur pa u përmbyllë, unë i kam propozuar Qeverisë që atë projekt ta marrë Ministria e Infrastrukturës dhe ta përfundoj si projekt të ri.

Kryetari, ministër të falënderoj për këtë prezantim detal, kërkoj që kjo mbledhje të jetë e transkriptuar në mënyrë që të ketë Ministria e Infrastrukturës si input për planet e ardhshme të saja, dhe çështjet që janë me rendësi për anëtarët e këtij komisioni. Por besoj edhe për deputetët, ajo që unë do të sugjeroja është se për neve është shumë e rëndësishme të bëhet një strategji afatgjatë të rrugëve që të mos na vijne ad-hoc vendimet për rrugët.

4. Të ndryshme **Çështjet vijuese**

Kryetari i njoftoj deputetët që ka hartuar një shkresë, ku në emër të Komisionit do të drejtohet Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetushmerisë së Ligjit për Trepçën. Në shkresë është paraqitur procedura para dhe gjatë miratimit dhe shqyrtimit në Komision të projektligjit si dhe do të kërkojmë më një opinion që duke marrë parasysh rëndësinë dhe urgjencën për nxjerrjen e Ligjit për Trepçën me ndikimin e tij esencial për hapjen e perspektivës zhvillimore të saj, dhe për të tejkaluar status – quon, kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese të adresojë kërkesat e parashtruesit (Lista Srpska) në një afat optimal për mundësinë e hyrjes në fuqi të Ligjit për Trepçën të aprovuar nga Kuvendi në afatet e parapara ligjore. Nëse kjo për ndonjë arsye procedurale nuk mund të arrihet, atëherë kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që të pezullojë të gjitha efektet e ligjeve tjera dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me Trepçën deri në përfundimin e kësaj lënde nga Gjykata Kushtetuese.

Komisioni përkrahu propozimin e kryetarit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa